



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 56 Prot

Tiranë, më 29, 04, 2013

VENDIM Nr. 252, datë 29.04.2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 29.04.2013, pasi shqyrtoi "Raportin e plotësuar të sondazheve arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: **Lagjja Nr. 18, Rruga "14 Nëntori"**, zona arkeologjike "B", **Durrës**, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës së KKA,

**VENDOSI:**

- I. Miratimin e raportit përfundimtar të sondazheve arkeologjike, të përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës për sheshin e ndërtimit të subjektit "**G&S**" sh.p.k, Lagjja Nr. 18, Rruga "14 Nëntori", Durrës.
- II. Të lejojë fillimin e punimeve në sheshin e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbimi 5- 6- 7 kate +1 kat nën tokë", zona arkeologjike "**B**", **Durrës**, të Subjektit "**G&S**" sh.p.k.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike deri në përfundim të procesit të gërmimit të themeleve, bazuar në kontratën dypalëshe midis "**G&S**" sh.p.k. dhe **Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik**.  
Mbikëqyrja arkeologjike do të kryhet nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës deri në arritjen e kuotës së gërmimit të parashikuar në projekt.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**VISAR ZHITI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171

Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)